

STELLA MARE SH.P.K.

**Raporti i audituesit të pavarur
dhe Pasqyrat Financiare më dhe
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

PËRMBAJTJA

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	4
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	1
PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHPËRFSHIRËSE	2
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	3
PASQYRA E FLUKSEVE TË PARASË	4
1. SHOQËRIA OPERUESE	5
2. BAZA E PËRGATITJES	5
3. PËRDORIMI I VLERËSIMEVE DHE GJYKIMEVE	5
6. STANDARDET E REJA DHE AMENDIMET	12
7. MANAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR	15
8. AKTIVE TË TRUPËZUARA, NETO	17
9. AKTIVE TË PATRUPËZUARA	17
10. LLOGARI TË ARKËTUESHME	18
11. AKTIVE TË TJERA	18
12. PARA NË ARKË DHE BANKË	18
13. KAPITALI THEMELTAR	19
14. LLOGARI TË PAGUESHME	19
15. TË PAGUESHME TË TJERA	19
16. TË ARDHURA	20
17. KOSTO E SHËRBIMEVE	20
18. TË ARDHURA TË TJERA	20
19. SHPENZIME PERSONELI	21
20. SHPENZIME TË PËRGJITHSHME DHE ADMINISTRATIVE	21
21. SHPENZIME FINANCIARE, NETO	22
22. TATIMI MBI FITIMIN	22
23. INSTRUMENTAT FINANCIARË	23
23.1. Rreziku i kredisë	23
23.2. Rreziku i likuiditetit	24
24.3 Rreziku i kursit të këmbimit	26
24. ANGAZHIME DHE PASIGURI	28
26. NGJARJE PAS PERIUDHËS RAPORTUESE	28

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Drejtimit dhe Aksionarëve të Stella Mare Sh.p.k.

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Stella Mare sh.p.k. (më poshtë "Shoqëria"), që përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2017, si dhe pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave gjithpërfshirëse, të ndryshimeve në kapital dhe të flukseve të parasë për vitin që mbyllet më këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare të veçanta, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2017, dhe performancën e saj financiare dhe të fluksit të parasë për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").

Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin *Përgjegjësia e Audituesit për auditimin e pasqyrave financiare të veçantë të raportit tonë*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me *Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël* (Kodi i "BSNEPK") së bashku me kërkesat etike që janë të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri (Kodi IEKA), dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe të Kodit BSNEPK.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Çështje të tjera

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin që mbyllet më datën 31 Dhjetor 2016, nuk kanë qenë të audituara.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrolle të brendshme, që Drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA- të do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticismin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- ▶ Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.
- ▶ Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm, që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- ▶ Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- ▶ Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.
- ▶ Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen e Stella Mare sh.p.k. përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Ernst & Young Ekspertë Kontabël të Autorizuar,
Dega në Shqipëri

Ernst & Young Certified

11 Qershor 2018
Tiranë, Shqipëri



Mario Vangjeli
Ekspert Kontabël i Regjistruar

Mario Vangjeli

STELLA MARE SH.P.K.*(Te gjitha shumat jane te shprehura ne '000 Lek, pervec rasteve ku shprehet ndryshe)***PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR
më 31 dhjetor 2017**

	Shënime	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Aktivitet			
Aktivitet afatgjata			
Aktive të trupëzuara, neto	8	1,553	1,115
Aktive të patrupëzuara, neto	9	1,557	1,318
Totali i aktiveve afatgjata		3,110	2,433
Aktivitet afatshkurtra			
Llogari të arkëtueshme, neto	10	158,542	8,899
Aktive të tjera	11	26,309	7
Para në arkë dhe bankë	12	58,611	29,598
Totali i aktiveve afatshkurtra		243,462	38,504
Totali i aktiveve		246,572	40,937
Kapitali			
Kapitali themeltar	13	27,314	27,314
Fitime të mbartura		78,764	28
Totali i kapitalit		106,078	27,342
Detyrimet			
Detyrimet afatshkurtra			
Llogari të pagueshme	14	125,022	12,916
Detyrime të tjera	15	15,472	679
Totali i detyrimeve afatshkurtra		140,494	13,595
Totali i detyrimeve dhe kapitalit		246,572	40,937

Këto pasqyra financiare u aprovuan nga Drejtimi i Stella Mare Sh.p.k. më datë 08 qershor 2018 dhe u firmosën nga:

Margjela Goca
Drejtore Përgjithshme
Ekzekutive

Juvenrleu Teqja
Drejtore e Përgjithshme
Financës



Pasqyra e pozicionit financiar duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 46, që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

STELLA MARE SH.P.K.*(Te gjitha shumat jane te shprehuara ne '000 Lek, pervec rasteve ku shprehet ndryshe)***PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE TË TJERA
GJITHPËRFSHIRËSE****Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për periudhën nga 2 nëntor 2016 (data themelimit) deri më 31 dhjetor 2016
Të ardhura	16	132,291	104
Kosto shërbimesh	17	(14,732)	(300)
Fitimi Bruto		117,558	(196)
Të ardhura të tjera	18	14,444	2,976
Shpenzime personeli	19	(18,620)	(1,555)
Amortizimi dhe zhvlerësimi	8,9	(730)	(20)
Shpenzime të përgjithshme dhe administrative	20	(14,091)	(1,144)
Shpenzime financiare, neto	21	(5,303)	(5)
Fitimi para tatimit		93,257	55
Tatimi mbi fitimin	22	(14,521)	(27)
Fitimi neto për vitin		78,736	28
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse		-	-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse, neto		78,736	28

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 28, që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

STELLA MARE SH.P.K.

(Te gjitha shumat jane te shprehuara ne '000 Lek, pervec rasteve ku shprehet ndryshe)

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL**Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

	Kapitali themeltar	Fitime të mbartura	Totali
Gjendja më 2 nëntor 2016 (data themelimit)	27,314	-	27,314
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse	-	28	28
Gjendja më 31 dhjetor 2016	27,314	28	27,342
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse	-	78,736	78,736
Gjendja më 31 dhjetor 2017	27,314	78,764	106,078

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 28, që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

STELLA MARE SH.P.K.*(Te gjitha shumat jane te shprehura ne '000 Lek, pervec rasteve ku shprehet ndryshe)***PASQYRA E FLUKSEVE TË PARASË****Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për periudhën nga 2 nëntor 2016 (data themelimit) deri më 31 dhjetor 2016
Flukset e parasë nga veprimtaritë shfrytëzuese			
Fitimi para tatimit		78,736	55
Rregullime për:			
Amortizimi	8,9	730	20
Diferenca nga kursi i këmbimit		5,303	5
Të Ardhurat e Akumuluar/Shpenzimet e Shtyra		(26,309)	-
Ndryshimet në kapitalin qarkullues:			
Rritje në llogaritë e arkëtueshme		(150,583)	(8,904)
Ulje/(Rritje) në të arkëtueshme të tjera		9,088	(7)
Rritje në llogaritë e pagueshme		111,348	12,916
Rritje në të pagueshme të tjera		14,793	679
Flukset neto nga veprimtaritë e shfrytëzimit		43,106	4,765
Tatim fitimi i paguar		(9,081)	(27)
Flukset e gjeneruara nga veprimtaritë e shfrytëzimit		34,025	4,737
Flukset e parasë nga veprimtaritë investuese			
Blerje e aktiveve të patrupëzuara	8,9	(783)	(1,318)
Blerje e aktiveve të trupëzuara	8,9	(625)	(1,135)
Flukset e përdorura për veprimtaritë investuese		(1,407)	(2,453)
Flukset e parasë nga veprimtaritë financuese			
Rritja e Kapitalit dhe rezervave		-	27,314
Flukset neto të përdorura në veprimtaritë financuese		-	27,314
Rritja e parasë në arkë dhe në bankë		32,618	29,598
Paraja në arkë dhe në bankë në fillim të periudhës		29,598	-
Efekti i ndryshimeve të kurseve të këmbimit në paratë në monedhë të huaj		(3,605)	-
Paraja në arkë dhe në bankë më 31 dhjetor		58,611	29,598

Pasqyra e flukseve të parasë duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 28, që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

STELLA MARE SH.P.K.

Shënime mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(të gjitha shumat janë të shprehura në '000 Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

1. SHOQËRIA OPERUESE

Stella Mare Sh.p.k. ("Shoqëria") u krijua në Shqipëri si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar më datë 2 nëntor 2016. Adresa kryesore e kompanisë është në Tiranë sipas adresës në vijim: Rruga Dervish Hima, Ambasador 3, hyrja e pare, apartamenti 21.

Fusha e aktivitetit të Shoqërisë është të shërbejë si agjensi për transport detar. Shoqëria ka si numër identifikimi unik ("NIPT") L62309016P.

Stella Mare operon si një agjent ("Agjenti") i Maersk Line A/S, në Danimark ("Parësori"), me qëllim për të promovuar dhe shitur shërbimet e tij në territorin e Shqipërisë dhe të mbajë dhe/ose të kordinojë ndonjë apo cdo aktivitet, duke përfshirë por jo duke u kufizuar me aktivitete portuale, të nevojshme për efikasitetin dhe performancën e mirë dhe të duhur të Parësorit.

Shoqëria është në bashkëpronësi të Balfin shpk dhe Milsped Doo Beograd. Më 31 Dhjetor 2017 shoqëria administrohet nga Marjeta Goce dhe Dejan Nikolic.

Më 31 Dhjetor 2017 shoqëria kishte 11 punonjës (31 Dhjetor 2016: 7 punonjës).

2. BAZA E PËRGATITJES

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF"), të publikuara nga Bordi Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK). Për periudhën që fillon më 2 nëntor 2016 deri më 31 dhjetor 2016, Shoqëria i ka përgatitur pasqyrat financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit ("SKK"). Pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 janë pasqyrat e para, të cilat Shoqëria i ka përgatitur në përputhje me SNRF-të.

SNRF 1 kërkon dhënie informacionesh shpjeguese të detajuara për efektin e tranzicionit nga SKK në SNRF. Duke marrë parasysh që Shoqëria ka operuar dy muaj në 2016, nuk ka impakt në pozicionin financiar, performancën financiare dhe flukset e parasë më 31 dhjetor 2016, meqenëse nuk ka transaksione të cilat kërkojnë riparaqitje për tranzicionin nga SKK në SNRF.

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike. Pasqyrat financiare janë shprehur në lekë dhe vlerat janë rrumbullakosur në mijëshen më të afërt ('000), përveçse kur është shprehur ndryshe.

3. PËRDORIMI I VLERËSIMEVE DHE GJYKIMEVE

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që Drejtimi të kryejë gjykime, vlerësime dhe supozime, të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto supozime.

Vlerësimet dhe supozimet e ndërlydhura rishikohen në vazhdimësi. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar dhe në ato pasardhëse të ndikuara. Në veçanti, informacioni mbi fushat e rëndësishme të vlerësimit të pasigurisë dhe gjykimeve kritike në aplikimin e politikave kontabël që kanë ndikimin më të rëndësishëm në shumën e njohur në pasqyrat financiare janë përshkruar më poshtë.

Tatim fitimi

Shoqëria është subjekti i tatimit fitimit në Shqipëri. Gjykim i rëndësishëm kërkohet në përcaktimin e shumës së tatimit fitimit aktual dhe tatimit të shtyrë. Ka transaksione dhe llogaritje për të cilat përcaktimi i tatimit është i pasigurt. Shoqëria njihet detyrime për çështje të pritshme të auditimit të taksave bazuar në vlerësime nëse do të detyrohen tatim shtesë. Kur rezultati përfundimtar i tatimit për këto çështje është ndryshe nga shumat e regjistruara fillimisht, diferencat do të ndikojnë në aktivin dhe detyrimin tatimor aktual dhe të shtyrë në periudhën kur bëhet përcaktimi.

Përcaktimi i vlerës së drejtë

Nuk ka politika kontabiliteti dhe dhënie informacionesh shpjeguese të rëndësishme të adoptuara nga Shoqëria, të cilat kërkojnë përcaktimin e vlerës së drejtë, për aktivet dhe pasivet financiare dhe jo-financiare. Vlera e drejtë është përcaktuar për qëllime matjeje dhe / ose prezantimi bazuar në metodat

STELLA MARE SH.P.K.

Shënime mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(të gjitha shumat janë të shprehura në '000 Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

3. PËRDORIMI I VLERËSIMEVE DHE GJYKIMEVE (VAZHDIM)

Përcaktimi i vlerës së drejtë (vazhdim)

në vijim. Supozimet në përcaktimin e vlerës së drejtë, kur janë të aplikueshme, prezantohen në shënimin përkatës.

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL

Polikat kontabël si më poshtë janë aplikuar në mënyrë të vazhdueshme në gjithë periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

(a) Transaksionet në monedha të huaja

Regjistrimet kontabël të entitetit përgatiten në Lek (ALL), që është monedha kryesore e mjedisit ekonomik ku operon Shoqëria.

Transaksionet në monedhë të huaj regjistrohen në monedhën Lek, duke aplikuar mbi monedhën e huaj kursin e momentit të këmbimit të kësaj monedhe me Lek-un në datën e veprimit. Aktivet monetare dhe detyrimet në monedhë të huaj në datën e mbylljes së bilancit në monedhë të huaj konvertohen duke përdorur kursin e këmbimit në atë datë. Diferencat e këmbimit që vijnë nga shlyerja/pagesa e mjeteve monetare ose nga konvertimi i mjeteve monetare me kurse këmbimi të ndryshme nga ato që janë përdorur në njohjen fillestare gjatë periudhës ushtrimore aktuale ose në pasqyrat financiare të mëparëshme, njihen si fitim ose humbje e periudhës ushtrimore kur ndodh diferenca. Mjetet jo-monetare që njihen me kosto historike në monedhë të huaj konvertohen duke përdorur kursin e këmbimit në datën e veprimit, ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë janë të vlerësuara me kursin e këmbimit në datën kur vlera e drejtë është vendosur. Diferencat e këmbimit nga rivlerësimi në datën e bilancit njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Kurset e këmbimit më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 janë:

Monedha	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
EUR/LEK	132.95	137.28
USD/LEK	111.10	125.79

(b) Instrumentat financiarë

Shoqëria fillimisht i njeh të arkëtueshmet dhe mjetet monetare në datën kur janë krijuar. Te gjitha aktivet e tjera financiare (duke përfshirë aktivet e caktuara në vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes) njihen fillimisht në ditën e tregtimit, në të cilën Shoqëria behet palë në provigjionin kontraktual të instrumentit. Shoqëria e çregjistrohen një aktiv financiar kur e drejta e përfitimit të flukseve të parasë të gjeneruara nga aktivi skadon, ose kur transferon të drejtën e përfitimit të flukseve të parasë të gjeneruara nga aktivi në një transaksion, në të cilin shumica e rreziqeve dhe të përfitimeve që lidhen më transferohen. Cdo interes që krijohet ose mbahet nga Shoqëria gjatë transferimit të aktivit financiar njihet si një aktiv ose pasiv i veçantë.

Një pasiv financiar çregjistrohet kur detyrimi ndaj nën këtë pasiv perfundon, eliminohet ose skadon. Kur një pasiv financiar ekzistues zëvendësohet nga një tjetër nga i njëjti huadhënës në kushte të ndryshme, ose kur termat e detyrimit ekzistues ndryshojnë shumë, ky lloj këmbimi ose ndryshimi trajtohet si një çregjistrim i pasivit fillestar dhe njohje e pasivit të ri. Ndryshimi në vlerën kontabël njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe humbjeve.

Aktivitet dhe pasivitet financiarë kompensohen dhe shuma neto prezantohet në pasqyrën e pozicionit financiar kur, dhe vetem kur, Shoqëria njeh të drejtën ligjore për të kompensuar shumat dhe ka për qëllim shlyerjen në baza neto ose njohjen e aktivitet dhe shlyerjen e detyrimit në të njëjtën kohë. Instrumentat financiare jo-derivativë të Shoqërisë përbëhen nga llogari të arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme, mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre, dhe llogari të pagueshme dhe të tjera të pagueshme.

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)**(b) Instrumentat financiarë (vazhdim)***Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre*

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre përfshijnë gjëndjet e arkës, llogaritë rrjedhëse bankare dhe depozitat afatshkurtra bankare. Për qëllime të pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përfaqësojnë para dhe depozita të pakufizuara me maturitet tre muaj ose më pak, të percaktuara si më sipër, e netuar me llogaritë e zbuluara bankare.

Llogaritë e arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen në fillim me vlerën reale dhe më pas me koston e amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv minus humbjet nga rënia në vlerë.

Huamarrje nga institucionet financiare

Huatë nga institucionet financiare njihen në fillim me vlerën e drejtë, e netuar me kostot e transaksionit. Pasivet financiarë më pas mat me koston e amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv, me shpenzimin e interesit që njihet në bazë të normës efektive.

Metoda e interesit efektiv është metoda e llogaritjes së koston së amortizuar të një pasivi financiar dhe alokimit të shpenzimit të interesit në periudhën e përshtatshme. Norma efektive e interesit është norma, e cila skonton saktësisht pagesat e mjeteve monetare të ardhshme të vlerësuara nëpërmjet jetës së pasivit financiar, ose kur është e përshtatshme, një periudhë më e shkurtër.

Llogaritë e pagueshme

Llogaritë e pagueshme njihen në fillim me vlerën reale dhe më pas me koston e amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Të tjera

Instrumenta financiarë të tjerë jo-derivativë maten me koston e amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv minus humbjet nga rënia në vlerë.

(c) Aktivet e trupëzuara*Njohja dhe matja*

Aktivët e trupëzuara paraqiten me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet nga rënia në vlerë, nëse ka.

Kosto përfshin shpenzime që lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kosto e aktiveve të ndërtuara nga vetë Shoqëria përfshin koston e materialeve dhe të fuqisë punëtore (nëse ka), si dhe ndonjë kosto tjetër që lidhet drejtpërdrejtë me vënien e aktivitetit në vendin dhe kushtet e nevojshme që ai të jetë i përdorshëm në mënyrën e synuar, si dhe kostot e çmontimit, largimit dhe restaurimit të vendit ku janë vendosur dhe kostot e huamarrjes të kapitalizuara. Kostot mund të përfshijnë dhe transferta nga të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse të fitimeve ose humbjeve nga mbrojtjet të fluksit të mjeteve monetare të kualifikueshme për blerjen e aktiveve të trupëzuara. Programet kompjuterike të blera, të cilat janë pjesë përbërëse e funksionimit të pajisjes përkatëse, kapitalizohen si pjesë e saj.

Kur pjesët e një elementi të aktiveve afagjata materiale kanë jetëgjatësi të ndryshme ato kontabilizohen si njësi (pjesë të rëndësishme) të aktiveve afatgjata materiale. Humbjet apo fitimet nga nxjerrja jashtë përdorimi e një elementi të aktiveve afagjata material, përcaktohen nga krahasimi i të ardhurave nga nxjerrja jashtë përdorimi me vlerën e mbartur të aktiveve afatgjata materiale dhe njihen neto nën grupin e “Të ardhurave të tjera” në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kostot vijuese

Nëse është e mundur që përfitime ekonomike që i atribuohen një elementi të aktiveve të trupëzuara do të rrjedhin në të ardhmen në Shoqëri dhe kostoja e tij mund të matet në mënyrë të besueshme, kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve të trupëzuara njihet me vlerën kontabël të elementit. Vlera e mbetur e aktiveve të zëvendësuara çregjistrohet. Kostot e shërbimeve ditore të

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)

(c) Aktivet e trupëzuara (vazhdim)

aktiveve të trupëzuara njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse (fitim ose humbje) në momentin kur ato ndodhin.

Amortizimi

Amortizimi llogaritet mbi vlerën e amortizueshme, e cila është kosto e nje aseti, ose cdo vlerë tjetër që zëvendëson koston, minus vlerën e mbetur. Amortizimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve duke përdorur metodën e vlerës së mbetur për pajisjet e zyrës me një normë amortizimi vjetore prej 20%, për pajisje kompjuterike me një normë amortizimi vjetore prej 25% dhe për mjete transporti me një normë amortizimi vjetore prej 20%. Kjo reflekton kryesisht mënyrën e pritur të konsumit të përfitimeve ekonomike të pritshme që janë pjesë e aktivit. Aktivet në progres nuk amortizohen.

Normat e amortizimit dhe vlera e mbetur e aktiveve të trupëzuara, nëse nuk janë të parëndësishme, rivlerësohen në fund të çdo periudhe raportuese.

(d) Aktivet e patrupëzuara

Njohja dhe matja

Aktivitetet e patrupëzuara paraqiten me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet nga rënia në vlerë, nëse ka.

Kostot vijuese

Kostot vijuese njihen në vlerën kontabël të aktivitetit të patrupëzuar vetëm nëse rrisin përfitimet ekonomike në të ardhmen dhe kostot mund të maten në mënyrë të besueshme. Të gjitha kostot e tjera, duke përfshirë Emrin e Mirë, njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse (fitim ose humbje) në momentin kur ato ndodhin.

Amortizimi

Amortizimi llogaritet mbi vlerën e asetit, ose çdo vlerë tjetër zëvendësuese për koston, minus vlerën e mbetur. Amortizimi njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse (fitim ose humbje) duke përdorur metodën e vlerës së mbetur me një normë amortizimi vjetore prej 25%.

(e) Rënia në vlerë

Aktivitetet financiare

Aktivitetet financiare vlerësohen në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka tregues për rënien në vlerë. Aktivitetet financiare konsiderohen të zhvlerësuar nëse ka evidencë objektive që tregon se një ose më tepër ngjarje që kanë ndodhur pas njohjes fillestare të aktivitetit kanë pasur një ndikim në rrjedhën e pritshme të mjeteve monetare të aktivitetit financiar.

Humbja nga rënia në vlerë e një aktiviteti financiar të matur me koston e amortizuar llogaritet si diferencë ndërmjet vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të rrjedhave të ardhshme të vlerësuar të mjeteve monetare që janë të skontuar me normën fillestare të interesit efektiv. Të gjitha humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse (fitim ose humbje) dhe reflektohen në një llogari zbritje ndaj të arkëtueshmeve. Kur një event vijues shkakton një zbritje në humbjen e rënies në vlerë, ulja në humbjen nga rënia në vlerë anulohet nëpërmjet fitimit dhe humbjes.

Aktivitetet jo-financiare

Në çdo datë raportimi Shoqëria rishikon vlerën kontabël të aktiveve jo-financiare, përveç inventarit dhe aktiveve tatimore të shtyra, për të përcaktuar nëse ka tregues për rëniet e vlerës. Nëse ka tregues të tillë, atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit në mënyrë që të përcaktohet rënia në vlerë. Vlera e rikuperueshme e një aktiviteti ose njësisë gjeneruese të parasë është vlera më e madhe midis vlerës në përdorim dhe vlerës së drejtë minus koston e shitjes.

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)**(e) Rënia në vlerë (vazhdim)**

Për përcaktimin e vlerës në përdorim, skontohej rrjedhat e ardhshme të parasë duke përdorur normën e skontimit para tatimit, e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut të vlerës në kohë të parasë dhe rreziqeve specifike të aktivitetit, për të cilat nuk janë bërë rregullime në vlerësimet e bëra për fluksin e mjeteve monetare.

Një humbje nga rënia në vlerë njihet nëse vlera e mbetur e një aktivi apo e njësisë së tij gjeneruese të parasë tejkalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse.

(f) Përfitimet e punonjësve

Kontributet e detyrueshme për sigurimet shoqërore dhe pensionet

Shoqëria, në rrjedhën normale të aktivitetit të saj, kryen pagesa për llogari të saj dhe për llogari të punonjësve të saj për të kontribuar për pensionet në përputhje me legjislacionin vendas. Kostot e paguara nga Shoqëria regjistrohen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse të të ardhurave (fitim ose humbje) kur ndodhin.

Leje vjetore e paguar

Të gjithë punonjësit kanë të drejtën e lejes vjetore të paguar bazuar në legjislacionin aktual vendas.

(g) Provigjonet

Provigjoni njihet nëse si rezultat i një ngjarjeje të kaluar, Shoqëria ka një detyrim aktual ligjor ose strukturor dhe nëse ekziston mundësia që të kërkohej një dalje burimesh e shprehur me përfitimet ekonomike për të shlyer detyrimin, e cila mund vlerësohet në mënyrë të besueshme. Provigjonet përcaktohen duke skontuar rrjedhat e ardhshme të parasë me një normë para tatimit, e cila paraqet vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike që lidhen me atë detyrim.

(h) Të ardhurat

Të ardhurat vlerësohen me vlerën reale të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme dhe paraqesin shumat e arkëtueshme për shërbimet e ofruara gjatë rrjedhës normale të aktivitetit. Shoqëria njihet të ardhurat që vijnë nga marrëdhënia Parësor – Agjent për pjesën në lidhje me agjensinë.

(i) Pagesat e qirasë

Qiratë klasifikohen si qira financiare kur termat e qirasë transferojnë në mënyrë thelbësore të gjitha rreziqet dhe përfitimet të qiramarrësi. Të gjitha qiratë e tjera klasifikohen si qira operacionale. Pagesat e bëra për qiranë operacionale njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes ose të të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse në mënyrë lineare përgjatë periudhës së qirasë. Shoqëria ka hyrë në një marrëdhënie qiramarrjeje për pronë komerciale, dhe ka përcaktuar, në bazë të vlerësimeve të termave dhe kushteve të marrëveshjes, që i mban të gjitha rreziqet dhe përfitimet e këtyre pronave dhe prandaj klasifikohen si qira operacionale.

Depozitat e qimarrësit

Detyrimi për depozitën e pronës së marrë me qira njihet fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas maten me koston e amortizuar, kur është materiale. Çdo diferencë ndërmjet vlerës së drejtë fillestare dhe vlerës nominale është i përfshirë si një element i të ardhurave nga qiraja operacionale dhe njihet me metodën lineare gjatë periudhës së qirasë.

(j) Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesi nga fondet e investuara në depozita bankare, dhe fitimet nga kursi i këmbimit.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit për huatë, humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare nëpërmjet fitimit dhe humbjes dhe humbje nga rënia në vlerë e aktiveve financiare (nëse ka). Të ardhurat nga kursi i këmbimit raportohen në bazë neto.

STELLA MARE SH.P.K.

Shënime mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(të gjitha shumat janë të shprehura në '000 Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE BAZË KONTABËL (VAZHDIM)

(k) Kostot e huamarrjes

Kostot e huamarrjes, që janë direkt të lidhura me blerjen, ndërtimin ose prodhimin e aktiveve, të cilat janë aktive që marrin kohë që të jenë gati për t'u përdorur ose shitur, i janë shtuar kostos së këtyre aktiveve, deri në periudhën që aktivet janë gati për përdorim apo shitje. Të ardhurat nga investimi të fituara nga investimet e përkohshme të huamarrjeve, në pritje të shpenzimeve në aktivet si me lart, zbriten nga kostot e huamarrjes të vlefshme për kapitalizim.

Të gjitha kostot e tjera të huamarrjes njohen ne pasqyrën e fitimit dhe humbjes në periudhën në të cilën ndodhin.

(l) Taksat

Tatim fitimi përbëhet nga taksa aktuale dhe e shtyrë. Shpenzimi tatim fitimit njihet në të pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, përveçse në rastet kur lidhet me elementë që njihen direkte në kapital, në të cilat njihet direkte në kapital. Tatimi aktual është shuma e pritur e tatimit të pagueshëm mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e raportimit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyrë njihet duke përdorur metodën e pasqyrave të pozicionit financiar, duke rezultuar në diferencë të përkohshme ndërmjet vlerës së mbartur të aktiveve dhe pasiveve për qëllime të raportimit financiar dhe shumave të përdorura për qëllime tatimi. Tatimi i shtyrë matet me normat e tatimit që priten të aplikohen ndaj diferencave të përkohshme kur anulohen, bazuar në legjislacionin që ka qenë në fuqi ose ka hyrë në fuqi në fund të periudhës së raportimit. Një aktiv tatimor i shtyrë njihet në masën që është e mundur që përfitimet e ardhshme të taksueshme do të jenë të vlefshme ndaj diferencave të përkohshme që mund të përdoren. Aktivet tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe zvogëlohen në masën që nuk është më e mundur që përfitimet e lidhura me atë takse do të realizohen.

(m) Kapitali aksionar

Kapitali aksionar i kompanise njihet në vlerën nominale. Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapital.

5. RAPORTIMI PËR HËRË TË PARË SIPAS SNRF

Këto pasqyra financiare, për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017, janë të parat të cilat Shoqëria i ka përgatitur në përputhje me SNRF. Për periudhën që fillon më 2 nëntor 2016 deri më 31 dhjetor 2016, Shoqëria ka përgatitur pasqyra financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK).

Shoqëria ka përgatitur pasqyrat financiare në përputhje me SNRF-të e aplikueshme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017, së bashku me të dhënat për periudhën krahasuese për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016, siç është përshkruar në përmbledhjen e politikave kontabël të rëndësishme. Shoqëria është krijuar më 2 nëntor 2016, e cila është dhe data e tranzicionit të SNRF.

Ky shënim shpjegon riklasifikimet e bëra nga Shoqëria në prezantimin e pasqyrave financiare SKK, duke përfshirë dhe pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016, dhe tranzicionin në SNRF. Nuk ka efekte të tjera të raportuara mbi pozicionin financiar, performancën financiare dhe fluksin e mjeteve monetare nga tranzicioni i Shoqërisë nga SKK në SNRF.

STELLA MARE SH.P.K.**Shënime mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017***(të gjitha shumat janë të shprehura në '000 Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)*

Shënimi	SKK	SNRF 1 - Prezantimi	Për periudhën nga 2	
			nëntor 2016 (data krijimit) deri më 31 dhjetor 2016	
Të ardhurat	A	21,488	(21,385)	104
Kostot e Shërbimit	A	(18,709)	18,409	(300)
Të ardhura bruto		2,779	(2,976)	(196)
Të ardhura të tjera	A	-	2,976	2,976
Kosto personeli		(1,555)	-	(1,555)
Amortizimi		(20)	-	(20)
Shpenzime të përgjithshme dhe administrative		(1,092)	-	(1,144)
Shpenzime financiare, neto		(5)	-	(5)
Fitimi para tatimit		55	-	55
Tatim fitimi		27	-	27
Fitimi neto i vitit		28	-	28
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-	-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin, neto nga taksat		28	-	28

Shënimet e rikonsilimit të pasqyrës së fitimit ose humbjes dhe të ardhurave gjithpërfshirëse për periudhën nga 2 nëntor 2016 (data krijimit dhe tranzicionit në SNRF) deri më 31 dhjetor 2016**A. SNRF 1 Prezantimi dhe dhenia e informacioneve shpjeguese**

Nën Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK), Shoqëria ka prezantuar të ardhurat dhe kostot e Parësorit si të vetat. Nën SNRF keto të ardhura dhe kosto janë eliminuar me njera tjetrën, duke prezantuar vetëm të ardhurat dhe kostot e agjentit në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse.

Nën SKK, Shoqëria i ka prezantuar të gjitha hyrjet monetare si të ardhura. Nën SNRF, të ardhurat e gjeneruara nga transaksione që kanë ndodhur vetëm një herë dhe nuk lidhen me aktivitetin kryesor të Shoqërisë, janë prezantuar nën të Ardhura të tjera.

6. STANDARDET E REJA DHE AMENDIMET**6.1 Standarde dhe interpretime të publikuara që nuk janë ende të aplikueshme**

Standardet dhe interpretimet që janë publikuar, por ende nuk janë efektive, deri në datën e lëshimit së pasqyrave financiare të Shoqërisë janë dhënë më poshtë. Shoqëria synon të aplikojë këto standarde, nëse janë të aplikueshme, kur ato të hyjnë në fuqi.

SNRF 9 Instrumentet Financiare

Në korrik 2014, Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK), publikoi vesionin final të SNRF 9 Instrumentat Financiare, i cili zëvendësoi SNK 39 Instrumentat Financiare: Njohja dhe Matja si dhe të gjitha versionet e mëparshme të SNRF 9. SNRF 9 përmbledh të treja aspektet e projektit të kontabilizimit të instrumentave financiarë: klasifikimi dhe matja, zhvlerësimi dhe kontabilizimi mbrojtës. SNRF 9 është efektiv për periudhat që fillojnë në ose pas 1 janar 2018, ku aplikimi i më hershëm është i lejuar. Me përjashtim të kontabilitetit mbrojtës, aplikimi në periudhat e mëparshme është i kërkuar, por informacioni krahasues nuk është i detyrueshëm. Për kontabilitetin mbrojtës, kërkesat përgjithësisht kërkojnë aplikim në periudhat në vijim, më një numër të përcaktuar përjashtimesh.

Shoqëria planifikon të aplikojë standartin e ri në datën efektive të përcaktuar dhe nuk do të rideklarojë informacionin krahasues. Gjatë vitit 2017, Shoqëria ka bërë një vlerësim të ndikimit të tre aspekteve të SNRF 9. Ky vlerësim bazohet në informacionin aktual dhe mund të jetë subjekt i ndryshimeve që vijnë nga informacioni i mëtejshëm i asyretueshëm që do të jetë në dispozicion të Shoqërisë në vitin 2018 kur Shoqëria të aplikojë SNRF 9. Në përgjithësi, Shoqëria nuk pret ndonjë ndikim domethënës në pasqyrën e pozicionit financiar dhe në kapital. Shoqëria nuk pret ndonjë ndryshim në humbjet nga zhvlerësimi. Për më tepër, Shoqëria, për shkak të llojeve të limituara të instrumentave financiarë, nuk pret ndryshime në klasifikimin e instrumentave financiarë (p.sh. llogari të arkëtueshme).

SNRF 15 Të Ardhurat nga Kontratat me Konsumatorët

SNRF 15 është publikuar në maj 2014, dhe i përmirësuar në prill 2016, dhe përdorur një model me pesë hapa për kontabilizimin e të ardhurave që rezultojnë nga kontratat me konsumatorët:

- identifikimi i kontratës me një klient
- identifikimi i detyrimeve të performancës në kontratë
- përcaktimi i çmimit të transaksionit
- shpërndarja e çmimit të transaksionit ndaj detyrimeve të performancës në kontratë, dhe
- Njohja e të ardhurave kur (ose si) njësia ekonomike përmbush një detyrim të performancës.

Sipas SNRF 15, të ardhurat njihen në një shumë që reflekton shumën në të cilën njësia ekonomike pret të ketë të drejtë në këmbim të transferimit të mallrave ose shërbimeve për një klient.

Standarti i ri i të ardhurave do të zëvendësojë të gjitha kërkesat aktuale të njohjes së të ardhurave sipas SNRF. Aplikimi është efektiv për periudhat më ose pas 1 janar 2018 dhe metodat e aplikimit janë ose aplikim i plotë i periudhave të mëparshme ose aplikim i modifikuar i periudhave të mëparshme. Aplikimi i më hershëm është i lejuar. Shoqëria planifikon të aplikojë standartin e ri në datën e kërkuar efektive duke përdorur metodën e e efektit të akumuluar, që do të thotë se efekti i aplikimit të këtij standardi (nëse ka) do të njihet në datën fillestare të aplikimit (p.sh. 1 janar 2018). Për rrjedhojë, Shoqëria nuk do të aplikojë kërkesat e SNRF 15 në periudhën prezantuese të paraqitur.

SNRF 16 Qiratë

SNRF 16 është lëshuar në janar 2016 dhe zëvendëson SNK 17 Qiradhënie, KIRFN 4 Përcaktimi nëse një Marrëveshje përmban një qira, SIC-15 Nxitjet e Qirasë Operative dhe KIS-27 Vlerësimi i Substancës së Transaksioneve që përfshijnë Formën Ligjore të Qirasë. SNRF 16 përcakton parimet për njohjen, matjen, paraqitjen dhe dhënien e informacioneve shpjeguese të qirasë dhe kërkon që qiramarrësit të japin llogari për të gjitha qiratë sipas një modeli të vetëm në bilanc, ngjashëm me kontabilitetin për qiratë financiare sipas SNK 17.

Kontabiliteti i qiradhënësive sipas SNRF 16 është në thelb i pandryshuar nga kontabilizimi i sotëm sipas SNK 17. SNRF 16 gjithashtu kërkon që qiramarrësi dhe qiradhënësi të shpalosin më shumë informacion

6. STANDARDET E REJA DHE AMENDIMET (VAZHDIM)**6.1 Standarde dhe interpretime të publikuara që nuk janë ende të aplikueshme (vazhdim)**

shpjegues se sa sipas SNK 17. SNRF 16 është efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019. Aplikimi i hershëm lejohet, por jo para se një entitet të zbatojë SNRF 15. Një qiramarrës mund të zgjedhë të zbatojë standardin duke përdorur një qasje të plotë retrospektive ose një modifikim retrospektiv. Dispozitat e tranzicionit të standardit lejojnë lehtësime të caktuara. Shoqëria nuk pret që aplikimi i këtij standarti të ri të ketë ndikim në pasqyrat e saj financiare, duke qenë se ajo nuk ka transaksione materiale si qiramarrëse.

SNRF 17 Kontratat e Sigurimeve

Në Maj 2017, BSNK publikoi SNRF 17 Kontratat e Sigurimeve (SNRF 17), një standard i ri kontabël i përgjithshëm për kontratat e sigurimeve. Sapo të hyjë në fuqi, SNRF 17 do të zëvendësojë SNRF 4 Kontratat e Sigurimeve (SNRF 4). SNRF 17 zbatohet për të gjitha llojet e kontratave të sigurimit (dmth jetë, jo-jetë, sigurimi i drejtpërdrejtë dhe risigurimi) pavarësisht llojit të subjekteve që i lëshojnë ato, si dhe garancive të caktuara dhe instrumenteve financiare me karakteristika të pjesëmarrjes së lirë. SNRF 17 është efektive për periudhat e raportimit që fillojnë më ose pas 1 janarit 2021, me shifra krahasuese të nevojshme. Aplikimi i hershëm është i lejuar, me kusht që entiteti të zbatojë gjithashtu SNRF 9 dhe SNRF 15 në ose para datës së zbatimit të parë të SNRF 17. Ky standard nuk është i zbatueshëm për Shoqërinë.

Interpretimi i KIRFN 22 Transaksionet në valutë të huaj dhe konsiderata paraprake

Interpretimi sqaron se në përcaktimin e kursit të këmbimit të çastit për t'u përdorur në njohjen fillestare të aktivitetit, shpenzimeve ose të ardhurave (ose një pjese të tij) në lidhje me ç' regjistrimin e një aktivi jo-monetar ose detyrimi jo-monetar që lidhet me shumën paraprake, data e transaksionit është data në të cilën një entitet fillimisht njihë aktivin jo-monetar ose detyrimin jo-monetar që rrjedh nga shuma paraprake. Nëse ka pagesa të shumëfishta ose parapagime, atëherë entiteti duhet të përcaktojë datën e transaksionit për secilën pagesë ose marrje të konsideratës paraprake. Subjektet mund të aplikojnë ndryshimet në bazë të plotë retrospektive.

Ndryshe, subjekti mund të zbatojë Interpretimin në mënyrë prospektive për të gjitha aktivitetet, shpenzimet dhe të ardhurat në fushën e saj që njihen fillimisht në ose pas:

- i. Fillimi i periudhës raportuese në të cilën entiteti për herë të parë zbaton interpretimin, ose
- ii. Fillimi i një periudhe raportuese paraprake të paraqitur si informacion krahasues në pasqyrat financiare të periudhës raportuese në të cilën entiteti zbaton interpretimin e parë.

Interpretimi është efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2018. Aplikimi i hershëm i interpretimit lejohet dhe duhet të raportohet. Megjithatë, meqenëse praktika e tanishme e Shoqërisë është në përputhje me Interpretimin, Shoqëria nuk pret ndonjë efekt në pasqyrat e saj financiare.

Interpretimi i KIRFN 23 Pasiguria mbi Trajtimin e Tatimit mbi të Ardhurat

Interpretimi trajton kontabilitetin për tatimin mbi të ardhurat kur trajtimet tatimore përfshijnë pasigurinë që ndikon në zbatimin e SNK 12 dhe nuk zbatohet për tatimet ose taksat jashtë fushëveprimit të SNK 12 dhe as nuk përfshin në mënyrë specifike kërkesat që lidhen me interesin dhe penalitetet në lidhje me trajtimin e pasigurt të tatimit. Interpretimi trajton në mënyrë specifike sa vijon:

- Nëse një entitet i konsideron trajtimet e pasigurta tatimore veçmas;
- Supozimet që një entitet bën në lidhje me ekzaminimin e trajtimeve tatimore nga autoritetet tatimore;
- Si një entitet përcakton fitimin e tatueshëm (humbje tatimore), bazat tatimore, humbjet tatimore të papërdorura, kreditë tatimore të papërdorura dhe normat tatimore;
- Si një entitet i konsideron ndryshimet në fakte dhe rrethana.

Një entitet duhet të përcaktojë nëse duhet të konsiderojë çdo trajtim tatimor të pasigurt veçmas ose së bashku me një ose më shumë trajtime të tjera tatimore të pasigurta. Metodologjia që parashikon më mirë zgjidhjen e pasigurisë duhet të ndiqet. Interpretimi është efektiv për periudhat raportuese vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019, por janë të disponueshme disa lehtësime të tranzicionit.

6. STANDARDET E REJA DHE AMENDIMET (VAZHDIM)

6.1 Standarde dhe interpretime të publikuara që nuk janë ende të aplikueshme (vazhdim)

Interpretimi i KIRFN 23 Pasiguria mbi Trajtimin e Tatimit mbi të Ardhurat (vazhdim)

Shoqëria do të zbatojë interpretimin nga data e hyrjes në fuqi. Meqenëse Shoqëria vepron në një mjedis tatimor në ndryshim, zbatimi i Interpretimit mund të ndikojë në pasqyrat e saj financiare dhe në zbulimet e kërkuara. Përveç kësaj, Shoqëria mund të ketë nevojë të krijojë procese dhe procedura për të marrë informacionin që është i nevojshëm për të zbatuar Interpretimin në kohën e duhur.

Përmirësimet vjetore cikli 2014-2016 (të lëshuara në dhjetor 2016)

Përmirësimet e mëposhtme nuk janë të aplikueshme për Shoqërinë, dhe përfshijnë:

SNRF 1 Përshtatja e parë e Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar - Zhdukja e përjashtimeve afatshkurtra për përshtatesit e parë – në fuqi nga 1 janar 2018.

SNK 28 Investimet në Shoqëritë dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta - Sqarimi që matja e të investuarve me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes është një zgjedhje për investim pas investimi – në fuqi nga 1 janar 2018, lejohet aplikimi për periudhat e mëparshme.

Përmirësimet vjetore cikli 2015-2017 (të lëshuara në dhjetor 2017)

Përmirësimet vjetore të ciklit 2015 – 2017, përfshin gjithashtu ndryshimet e mëposhtme:

SNK 12 Tatimet mbi të Ardhurat - Pasojat e tatimit mbi të ardhurat e pagesave të instrumenteve financiare të klasifikuara si kapital – efektiv për periudhat raportuese vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019, lejohet aplikimi për periudhat e mëparshme.

SNRF 3 Kombinimet e Biznesit - Interesat e mbajtura më parë në një operacion të përbashkët - efektiv për periudhat raportuese vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019, dhe nuk është i aplikueshëm për Shoqërinë.

SNRF 11 Marrëveshjet e Përbashkëta - Interesat e mbajtura më parë në një operacion të përbashkët – efektiv për periudhat raportuese vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019, dhe nuk është i aplikueshëm për Shoqërinë.

SNK 23 Kostot e Huamarrjes - Kostot e huamarrjes të pranueshme për kapitalizim – efektiv për periudhat raportuese vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019, dhe nuk është i aplikueshëm për Shoqërinë.

6.2 Standarde e publikuara dhe efektive

SNK 7 Iniciativa për dhënie informacionesh shpjeguese - Ndryshime në SNK 7 - Amendimi është efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2017. Ndryshimet në *SNK 7 Pasqyra e flukseve të mjeteve monetare* janë pjesë e Iniciativës së Publikimit të BSNK-së dhe ndihmojnë përdoruesit e pasqyrave financiare të kuptojnë më mirë ndryshimet në borxhin e një entiteti. Ndryshimet kërkojnë që entitetet të japin informacion shpjegues rreth publikimeve në detyrimet e tyre që rrjedhin nga aktivitetet e financimit, duke përfshirë edhe ndryshimet që rrjedhin nga flukset e mjeteve monetare dhe ndryshimet e nje forme jo-monetare (siç janë fitimet ose humbjet në valutë të huaj). Në aplikimin fillestar të ndryshimeve, entiteteve nuk u kërkohet të japin informacion krahasues për periudhat e mëparshme. Lejohet aplikimi i hershëm. Amendamentet synojnë të japin informacion për të ndihmuar investitorët të kuptojnë më mirë ndryshimet në borxhin e një entiteti. Shoqëria ka zbatuar ndryshimin.

Deklarata e praktikave të SNRF-ve 2: Marrja e vendimeve të materialitetit - Shoqërive u lejohet të zbatojnë udhëzimet në Deklaratën e Praktikës (DP/PV) në pasqyrat financiare të përgatitura në çdo periudhë kohore pas 14 shtatorit 2017. Deklarata e Praktikës përmban udhëzime jo të detyrueshme për të ndihmuar entitetet që të bëjnë gjykime materialiteti gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare për qëllime të përgjithshme. Gjithashtu, Deklarata e Praktikës, mund të ndihmojë përdoruesit e pasqyrave financiare për të kuptuar se si një entitet bën gjykime të materialitetit në përgatitjen e pasqyrave financiare.

6. STANDARDET E REJA DHE AMENDIMET (VAZHDIM)

6.2 Standarde e publikuara dhe efektive

Deklarata e Praktikës përmban udhëzime në tri fusha kryesore:

- Karakteristikat e përgjithshme të materialitetit;
- Një proces me katër hapa që mund të zbatohet në bërjen e gjykimeve të materialitetit gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare. Ky proces përshkruan se si një entitet mund të vlerësojë nëse informacioni është material për qëllimet e njohjes, matjes, prezantimit dhe zbulimit;
- Si të bëhen gjykimet e materialitetit në rrethana specifike, domethënë, informacionet e periudhave të mëparshme, gabimet dhe besëlidhjet dhe në kontekstin e raportimit të ndërmjetëm.

Për më tepër, DP diskuton ndërveprimin midis vendimeve të materialitetit që një entitet duhet të bëjë dhe ligjet dhe rregulloret vendore. DP përfshin shembuj që ilustrojnë se si një njësi ekonomike mund të zbatojë udhëzimet. Meqenëse DP është një dokument jo i detyrueshëm, ai nuk ndryshon ose nuk paraqet ndonjë kërkesë në SNRF. Sidoqoftë, DP siguron udhëzime të dobishme për subjektet që bëjnë gjykime të materialitetit dhe në këtë mënyrë mund të përmirësojnë efektivitetin e komunikimit të pasqyrave financiare. Shoqëria ende nuk ka bërë asnjë gjykim të materialitetit.

SNK 12 Njohja e aktiveve tatimore të shtyra për humbjet e porealizuara - Ndryshimet në SNK 12 - Ndryshimi është efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2017. BSNK ka lëshuar amendimet në *SNK 12 Tatimet mbi të Ardhurat* për të sqaruar kontabilizimin për aktivet tatimore të shtyra për humbjet e porealizuara mbi instrumentet e borxhit të matura me vlerën e drejtë. Për më tepër, amendamentet sqarojnë se një entitet duhet të marrë në konsideratë nëse ligji tatimor kufizon burimet e fitimeve të tatuashme, ndaj të cilave mund të bëjë zbritje për kthimin e kësaj difference të përkohshme të zbritshme.

SNRF 12 Publikimi i interesave në entitete të tjera - Ndryshimet hyjnë në fuqi nga 1 janari 2017 dhe duhet të zbatohen në mënyrë retrospektive.

7. MANAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rreziqeve të mëposhtme nga përdorimi i instrumenteve financiare:

- rreziku i kredisë,
- rreziku i likuiditetit, dhe
- rreziku i tregut.

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Shoqërisë ndaj secilit prej rreziqeve të mësipërm, objektivat, politikat dhe proceset e Shoqërisë për matjen dhe manaxhimin e rrezikut dhe manaxhimin e kapitalit. Shënime të mëtejshme sasiore janë të përfshira në këto pasqyra financiare.

Politikat e manaxhimit të rrezikut të Shoqërisë janë vendosur për të identifikuar dhe analizuar rreziqet që përball Shoqëria, për të vendosur limitet dhe kontrollet e përshtatshme, dhe për të monitoruar rreziqet dhe zbatimin e limiteve. Politikat dhe sistemet e manaxhimit të rrezikut rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut dhe në aktivitetet e Shoqërisë. Shoqëria, përmes trajnimeve dhe standardeve dhe procedurave të manaxhimit, synon të zhvillojë një ambient kontrolli konstruktiv dhe të disiplinuar, në të cilin të gjithë punonjësit i kuptojnë rolet dhe detyrimet e tyre.

Rreziku i kredisë

Rreziku i kredisë është rreziku i humbjeve financiare për Shoqërinë nëse një klient ose palë tjetër nuk përmbush detyrimet kontraktuale dhe vjen kryesisht nga llogaritë e arkëtueshme të Shoqërisë.

Natyra e sektorit të biznesit nuk lejon përqëndrim të lartë të rrezikut të kredisë në lidhje me llogaritë e arkëtueshme meqë Shoqëria i mban dokumentat ligjore të kerkuar për plotesimin e shërbimit. Shoqëria nuk lejon lëshimin e dokumentave pa marrë prova për pagesën dhe në raste që i lëshon, vlerëson gjendjen kreditore të klientit.

Lejimi për llogaritë e arkëtueshme të dyshimta është i prezantuar në një shumë që konsiderohet t nevojshme për të mbuluar rreziqet e mundshme në arkëtimin e balancave të llogarive të arkëtueshme.

Entiteti përdor shërbimet e palëve të treta për të siguruar llogaritë e arkëtueshme dhe mbrojtur pozicionin në rast mos-arkëtimi.

7. MANAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**Rreziku i likuiditetit**

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Shoqëria të mos jetë në gjendje të përmbushë detyrimet e saj në kohën e maturimit të tyre. Mënyra që ndjek Shoqëria në drejtimin e rrezikut të likuiditetit është të sigurojë se do të ketë vazhdimisht likuiditet të mjaftueshëm për të shlyer detyrimet e saj në kohë, në kushte normale dhe të vështira, pa shkaktuar humbje të papranueshme dhe pa rrezikuar reputacionin e Shoqërisë.

Shoqëria gjeneron rrjedhje parash të konsiderueshme nga aktivitetet e saj operative në masën që ajo beson që rreziku i saj i likuiditetit është i pakonsiderueshëm.

Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku që ndryshimet në çmimet e tregut, si kurset e këmbimit dhe normat e interesit, do të ndikojnë tek të ardhurat e Shoqërisë. Objektivi i drejtimit të rrezikut të tregut është të kontrollojë se ekspozimet e tregut janë brenda parametrave të pranueshëm duke optimizuar kthimin.

Rreziku i normave të interesit

Shoqëria nuk përballet me rrezikun e normës së interesit pasi nuk ka huamarrje në datën e pasqyrës së pozicionit financiar.

Rreziku i kursit të këmbimit

Shoqëria nuk përballet me rreziqe të rëndësishme të kursit të këmbimit nga veprimtaria normale. Shoqëria ka gjendje të konsiderueshme në Euro dhe Dollar nga klientët e saj dhe kundrejt furnitorëve të saj, fakt i cili e mbron Shoqërinë ndaj rrezikut të kursit të këmbimit. Drejtimi nuk ka hyrë në ndonjë marrëveshje derivative për t'u mbrojtur nga ky rrezik.

Analiza e ndjeshmërisë

Me anën e manaxhimit të rrezikut të normave të interesit dhe të kursit të këmbimit, Shoqëria synon të reduktojë ndikimin e luhatjeve afatshkurtra në fitimet e Shoqërisë. Në një periudhë afatgjatë, sidoqoftë, ndryshimet e vazhdueshme në kurset e këmbimit dhe normat e interesit mund të kenë një ndikim në fitim. Më 31 dhjetor 2017 është vlerësuar se një ndryshim në përqindjen e normave të interesit në vlerën e Lek-ut kundrejt monedhave të tjera nuk do të ketë ndikim të konsiderueshëm në fitimin e Shoqërisë para tatimit mbi fitimin.

Ndryshim në normen e USD me +/- 5% ndikon në fitimin para tatimit mbi fitimin me +/- ALL 78

Ndryshim në normen e EUR me +/- 5% ndikon në fitimin para tatimit mbi fitimin me +/- ALL 78

Manaxhimi i kapitalit

Politika e Shoqërisë është të mbajë një bazë të fortë kapitali në mënyrë që të ruajë besueshmërinë e investitorëve dhe kreditorëve dhe të mbështesë zhvillimin e mëtejshëm të biznesit. Drejtimi monitoron kthimet nga kapitali, të cilat Shoqëria i përcakton si të ardhura neto të shfrytëzimit ndaj totalit të kapitalit, duke përjashtuar aksionet e preferuara të parevokueshme dhe interesat e pakicës. Drejtimi gjithashtu monitoron nivelin e dividendëve ndaj ortakut. Gjatë këtij viti nuk ka patur ndryshime në mënyrën e manaxhimit të kapitalit. Shoqëria nuk është subjekt i kërkesave të kapitalit të vendosura nga ente rregullatore.

STELLA MARE SH.P.K.**Shënime mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017***(të gjitha shumat janë të shprehura në '000 Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)***8. AKTIVE TË TRUPËZUARA, NETO**

	Kompjuterë dhe pajisje zyre	Totali
Kosto		
Më 2 nëntor 2016	-	-
Shtesa	1,135	1,135
Më 31 dhjetor 2016	1,135	1,135
Shtesa	783	783
Më 31 dhjetor 2017	1,919	1,919
Zhvlerësim i akumuluar		
Më 2 nëntor 2016	-	-
Zhvlerësimi për vitin	(20)	(20)
Më 31 dhjetor 2016	(20)	(20)
Zhvlerësimi për vitin	(346)	(346)
Më 31 dhjetor 2017	(366)	(366)
Vlera neto		
Më 31 dhjetor 2016	1,115	1,115
Më 31 dhjetor 2017	1,553	1,553

9. AKTIVE TË PATRUPËZUARA

	Programe Kompjuterike	Totali
Kosto		
Më 2 nëntor 2016	-	-
Shtesa	1,318	1,318
Më 31 dhjetor 2016	1,318	1,318
Shtesa	624	624
Më 31 dhjetor 2017	1,942	1,942
Amortizimi i akumuluar		
Më 2 nëntor 2016	-	-
Amortizimi për vitin	-	-
Më 31 dhjetor 2016	-	-
Amortizimi për vitin	(385)	(385)
Më 31 dhjetor 2017	(385)	(385)
Vlera neto		
Më 31 dhjetor 2016	1,318	1,318
Më 31 dhjetor 2017	1,557	1,557

STELLA MARE SH.P.K.**Shënime mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017***(të gjitha shumat janë të shprehura në '000 Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)***10. LLOGARI TË ARKËTUESHME**

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Llogari të arkëtueshme nga palët e treta	152,146	7,481
Llogari të arkëtueshme nga principali	6,396	1,418
Totali	158,542	8,899

Llogaritë e arkëtueshme nga palët e lidhura lidhen kryesisht me ringarkimin e shpenzimeve të bëra nga Kompania si agjent në emër të Maersk Lines A / S si principal.

	Totali	Pa vonesë dhe të pa provigjionuara	Me vonesë por jo të provigjionuara				Me vonesë dhe të provigjionuara
			<30 ditë	31-60 ditë	61-90 ditë	>90 ditë	
2017	158,542	20,677	47,548	32,873	20,405	37,039	-
2016	8,899	-	8,899	-	-	-	-

11. AKTIVE TË TJERA

Aktive të tjera më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Të arkëtueshme të tjera	21,155	-
Të ardhura të akumuluar	4,821	-
Shpenzime të shtyra	333	-
TVSH e arkëtueshme	-	7
Totali	26,309	7

Të arkëtueshmet e tjera përbëjnë fatura të paregjistruara drejt Maersk Line A / S për pagesat e trajtimit të terminaleve të bëra për muajin dhjetor 2017. Të ardhurat e përlllogaritura lidhen me komisionet e agjencive dhjetor 2017 që nuk janë faturuar në Maersk Line A / S.

12. PARA NË ARKË DHE BANKË

Para në arkë dhe bankë më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Para në arkë		
Në ALL	5	10
Në EUR	51	7
Në USD	-	6
	56	23
Para në bankë		
Në ALL	2,241	951
Në EUR	6,692	18,842
Në USD	49,622	9,783
	58,554	29,576
Totali i parasë në arkë dhe bankë	58,611	29,598

STELLA MARE SH.P.K.

Aksionerët

(të gjitha shumat janë të shprehura në '000 Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

13. KAPITALI THEMELTAR

Numri dhe vlera e aksioneve të regjistruara deri në 31 dhjetor 2017

Në dhjetor 2017 dhe 2016 kapitali aksionar i regjistruar është ALL 27,314. Numri total i aksioneve është 2, me vlerë prej ALL 13,657 për aksion.

Aksionerët

Tabela e mëposhtme tregon pozicionin dhe kontributin aktual të aksionerëve të Stella Mare në 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016, në:

Aksioneri	% Kapital	Kapitali i regjistruar ne ALL (kontributi paguar)
Balfin Shpk	50%	13,657
Milsped Doo Beograd	50%	13,657
Totali	100%	27,314

14. LLOGARI TË PAGUESHME

Llogaritë e pagueshme në 31 dhjetor 2017 dhe 2016 janë detajuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Të pagueshme ndaj palëve të treta	121,451	12,677
Të pagueshme ndaj principalit	3,571	238
Totali	125,022	12,916

15. TË PAGUESHME TË TJERA

Të pagueshme të tjera në 31 dhjetor 2017 dhe 2016 përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Tatimi i pagueshëm mbi të ardhurat	5,440	27
Garanci	4,136	-
TVSH e pagueshme	2,899	-
Të pagueshme për punonjësit	1,094	321
Detyrimet e tatimeve të punonjësve	782	263
Shpenzimet e përlllogaritura	1,044	43
Tatimi në burim i pagueshëm	77	26
Totali	15,472	679

Garancitë lidhen me shumat e mbajtura nga konsumatorët për të mbuluar humbjet e papritura për kontenierët.

STELLA MARE SH.P.K.**Shënime mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017***(të gjitha shumat janë të shprehura në '000 Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)***16. TË ARDHURA**

Të ardhurat e njohura për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 përbëhen si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017	Peridha nga 2 nëntori 2016 deri më 31 dhjetor 2016
Komisionet e Agjencisë	41,069	-
Të ardhura nga tarifat e trajtimit në terminal	50,583	100
Të ardhura nga Magazinimi	30,077	-
Të ardhura nga Transportimi dhe Energjia Elektrike	10,561	4
Totali	132,291	104

Komisioni i Agjencisë përfaqëson të ardhurat sipas Marrëveshjes Agjent-Principal midis kompanisë dhe Maersk Line A/S.

Të ardhurat nga tarifat dhe magazinimi për trajtimin e terminalit përfaqësojnë të ardhura nga ngarkimi dhe shkarkimi i kontejnerëve në port. Gjatë vitit 2017 këto të hyra u ndanë ndërmjet Agjentit dhe Drejtorit në mënyrë progresive deri në shkurt të vitit 2018, ku të gjitha të ardhurat e krijuara nga Ngarkesat e Ngarkimit dhe Magazinave të Terminalit i transferohen Drejtorit.

17. KOSTO E SHËRBIMEVE

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017	Peridha nga 2 nëntori 2016 deri më 31 dhjetor 2016
Shpenzimet e Transportit dhe Energjisë Elektrike	14,732	300
TOTALI	14,732	300

18. TË ARDHURA TË TJERA

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017	Peridha nga 2 nëntori 2016 deri më 31 dhjetor 2016
Shërbime transporti mallrash	14,444	2,976
TOTALI	14,444	2,976

Shërbimet e mallrave përfaqësojnë të ardhurat nga shërbimi i kryer për kontratat e transportit detar për një kohë të limituar në fillim të vitit 2017. Në vijim dhe në të ardhmen, Shoqëria do të veprojë vetëm si agjent në lidhje me transportin.

STELLA MARE SH.P.K.**Shënime mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017***(të gjitha shumat janë të shprehura në '000 Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)***19. SHPENZIME PERSONELI**

Shpenzime personeli si dhe shpenzimet e lidhura me to për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 janë si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017	Peridha nga 2 nëntori 2016 deri më 31 dhjetor 2016
Paga	15,210	1,386
Sigurime shoqërore dhe kontribute	1,745	155
Shpenzime të tjera	1,665	14
Totali	18,620	1,555

20. SHPENZIME TË PËRGJITHSHME DHE ADMINISTRATIVE

Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 janë si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017	Peridha nga 2 nëntori 2016 deri më 31 dhjetor 2016
Konsulencë Financiare	3,356	-
Tarifat bankare	1,915	57
Qira	1,718	418
Dieta	1,251	106
Qeraja operationale	896	-
Shpenzimet e përfaqësimit	830	41
Shpenzimet e telekomunikacionit	729	47
Shpenzime të tjera	633	221
Shërbimet e TI	616	23
Shpenzimet e sigurimit	380	-
Shpenzimet e auditimit	372	-
Mirëmbajtja e zyrës	299	22
Fikse	277	67
Tarifat Doganore	265	11
Shpenzimet e karburantit	158	13
Sherbime	152	16
Taksat lokale	108	-
Shpenzimet ligjore	97	102
Shpenzimet e marketingut	39	-
Totali	14,091	1,144

STELLA MARE SH.P.K.**Shënime mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017***(të gjitha shumat janë të shprehura në '000 Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)***21. SHPENZIME FINANCIARE, NETO**

Shpenzimet dhe të ardhurat financiare neto për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 janë si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017	Peridha nga 2 nëntori 2016 deri më 31 dhjetor 2016
Humbje nga konvertimi	44,662	57
Të ardhura nga konvertimi	(39,358)	(52)
Shpenzime financiare, neto	5,303	5

22. TATIMI MBI FITIMIN

Kompania është subjekt i tatimit mbi të ardhurat në Shqipëri me një normë të tatimit mbi të ardhurat prej 15% për vitin 2017 dhe 2016. Formularët e deklaratave tatimore dorëzohen çdo vit. Të ardhurat dhe shpenzimet e deklaruara për qëllime tatimore konsiderohen si një vete-deklarim derisa ato të shqyrtohen dhe vlerësohen nga autoritetet tatimore. Ligjet dhe rregullat tatimore shqiptare janë subjekt i interpretimit nga autoritetet tatimore.

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Peridha nga 2 nëntori 2016 deri më 31 dhjetor 2016
Fitimi i vitit para tatimit	93,257	55
Shpenzimet e pa zbritshme	2,942	125
Shpenzimet e përlogaritur	607	-
Fitimi para tatimit	96,807	180
Shpenzimet e tatimit mbi fitimin për vitin (15%)	(14,251)	(27)
Tatimi mbi fitimin i arkëtueshëm/(i pagueshëm) më 1 janar	(27)	-
Tatimi mbi fitimin i paguar gjatë vitit	9,081	-
Tatimi mbi fitimin (i pagueshëm)/i arkëtueshëm më 31 dhjetor	5,467	(27)

Të ardhurat e deklaruara në sistemin e Autoritetit të Taksave për vitin që përfundon më 2017 dhe 2016 janë të ndryshme nga ato të kontabilitetit sepse Kompania si agjent tatimor ka përfshirë në deklaratën e saj edhe faturat e shitjes në emër të Maersk Line A/S. Këto shitje nuk janë të ardhura për kompaninë dhe rrjedhimisht nuk janë pjesë e të ardhurave sipas kontabilitetit në tabelën e mësipërme. Më poshtë paraqitet një barazim ndërmjet të ardhurave sipas deklaratave dhe të ardhurave kontabël:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Peridha nga 2 nëntori 2016 deri më 31 dhjetor 2016
<i>Të ardhurat e faturuara si agjent</i>		
Të ardhurat e raportuara në librat e TVSh-së	1,155,521	21,488
Faturat e transportit në emër të Principalit	(715,462)	(14,614)
Shitjet e tjera në emër të Principalit	(296,716)	(3,795)
Faturat automatike	(1,430)	-
<i>Ndikimi i të ardhurave të përlogaritura</i>		
Të hyrat e përlogaritura për 2016, të faturuara në 2017	-	-
Të hyrat e përlogaritura për 2017, të faturuara në 2018	4,821	-
Të ardhurat totale të raportuara në pasqyrën e të ardhurave	146,735	3,079

STELLA MARE SH.P.K.**Shënime mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017***(të gjitha shumat janë të shprehura në '000 Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)***22. TATIMI MBI FITIMIN (VAZHDIM)**

Rakordimi midis normës efektive të tatimit dhe normës së përdorur për llogaritjen e fitimit për qëllime fiskale është paraqitur më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017		Peridha nga 2 nëntori 2016 deri më 31 dhjetor 2016	
	Norma efektive		Norma efektive	
Fitimi para tatimit		93,257		55
Taksa me normën 15% (2016: 15%)	15.00%	13,989	15.00%	8
Efekti i shpenzimeve të panjohura	0.47%	441	34.21%	19
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin për vitin	15.47%	14,430	49.21%	27

23. INSTRUMENTAT FINANCIARË**23.1. Rreziku i kredisë**

Ekspozimi ndaj rrezikut të kredisë:

Vlera e mbartur e aktiveve financiare paraqet maksimumin e ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë. Maksimumi i ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 është paraqitur më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Para në bankë	58,611	29,598
Llogari të arkëtueshme, neto	158,542	8,899
Aktive të tjera	21,155	-
Totali	238,308	38,497

STELLA MARE SH.P.K.**Shënime mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017***(të gjitha shumat janë të shprehura në '000 Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)***23. INSTRUMENTAT FINANCIARË (VAZHDIM)****23.2. Rreziku i likuiditetit**

Aktivet dhe detyrimet financiare, duke përfshirë pagesat e interesit më 31 dhjetor 2017, sipas maturitetit kontraktual janë detajuar më poshtë:

	Më pak se 3 muaj	3 deri në 12 muaj	Më shumë se një vit	Totali
Aktive financiare				
Llogari të arkëtueshme, neto	101,099	57,443	-	158,542
Aktive të tjera	-	21,155	-	21,155
Para në arkë dhe bankë	58,611	-	-	58,611
Totali i aktiveve financiare	159,710	78,598	-	238,308
Detyrime financiare				
Detyrime të tjera	10,293	-	4,136	14,428
Llogari të pagueshme	123,365	1,657	-	125,022
Totali i detyrimeve financiare	133,658	1,657	4,136	139,450
Hendeku i likuiditetit	26,052	76,941	(4,136)	98,858
Hendeku kumulativ	26,052	102,993	98,858	-

STELLA MARE SH.P.K.**Shënime mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

(të gjitha shumat janë të shprehura në '000 Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

23. INSTRUMENTAT FINANCIARË (VAZHDIM)**23.2. Rreziku i likuiditetit (vazhdim)**

Aktivitet dhe detyrimet financiare, duke përfshirë pagesat e interesit më 31 dhjetor 2016, sipas maturitetit kontraktual janë detajuar më poshtë:

	Më pak se 6 muaj	6 deri në 12 muaj	Më shumë se një vit	Totali
Aktive financiare				
Llogari të arkëtueshme, neto	8,899	-	-	8,899
Aktive të tjera	-	-	-	-
Para në arkë dhe bankë	29,598	-	-	29,598
Totali i aktiveve financiare	38,497	-	-	38,497
Detyrime financiare				
Detyrime të tjera	636	-	-	636
Llogari të pagueshme	12,916	-	-	12,916
Totali i detyrimeve financiare	13,552	-	-	13,552
Hendeku i likuiditetit	24,945	-	-	24,909
Hendeku kumulativ	24,945	24,945	24,945	-

STELLA MARE SH.P.K.**Shënime mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

(të gjitha shumat janë të shprehura në '000 Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

23. INSTRUMENTAT FINANCIARË (VAZHDIM)**24.3 Rreziku i kursit të këmbimit**

Ekspozimi i Shoqërisë ndaj rrezikut të kursit të këmbimit më 31 dhjetor 2017 është si më poshtë:

	Euro	USD	Lek	Vlera kontabël
Llogari të arkëtueshme, neto	113,069	44,218	1,256	158,542
Aktive të tjera	153	2	86	23,811
Para në arkë dhe bankë	6,743	49,622	2,246	58,611
Totali i aktiveve monetare	138,956	98,506	3,502	240,964
Llogari të pagueshme	54,644	69,660	719	125,022
Detyrime të tjera	665	3,136	10,628	14,429
Totali i detyrimeve monetare	55,309	72,796	11,347	139,451
Ekspozimi neto	83,648	25,710	(7,845)	101,513

STELLA MARE SH.P.K.**Shënime mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017***(të gjitha shumat janë të shprehura në '000 Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)***24. INSTRUMENTAT FINANCIARË (VAZHDIM)****24.3 Rreziku i kursit të këmbimit (vazhdim)**

Ekspozimi i Shoqërisë ndaj rrezikut të kursit të këmbimit më 31 dhjetor 2016 është si më poshtë:

	Euro	USD	Lek	Vlera kontabël
Llogari të arkëtueshme	2,667	6,232	960	8,899
Aktive të tjera	-	-	7	7
Para në arkë dhe bankë	18,849	9,789	-	29,598
Totali i aktiveve monetare	21,516	16,021	967	38,504
Llogari të pagueshme	9,196	254	3,466	12,916
Detyrime të tjera	-	-	636	636
Totali i detyrimeve monetare	9,196	254	4,102	13,552
Ekspozimi neto	12,321	15,767	(3,135)	24,953

STELLA MARE SH.P.K.**Shënime mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017***(të gjitha shumat janë të shprehura në '000 Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)***24. ANGAZHIME DHE PASIGURI****Pasiguria e pretendimeve ligjore**

Në rrjedhën normale të aktivitetit, Shoqëria mund të përfshihet në çështje të ndryshme ligjore. Në datën e këtij raporti nuk ka çështje të rëndësishme ligjore të hapura kundër Shoqërisë të cilat kërkojnë rregullime apo paraqitje në pasqyrat financiare.

Angazhimet operative të qirasë - Kompania si qiramarrëse

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Brenda vitit	2,119	213
Pas një viti por jo më shumë se pesë vite	7,040	-
Më shumë se pesë vite	-	-
	9,159	213

25. DISPOZITAT E PALËVE TË TRETA

Tabela e mëposhtme tregon shumat totale të transaksioneve në të cilat përfshihen palët e treta për vitin financiar përkatës.

		Shitje ndaj palëve të treta	Blerje nga palët e treta	Shumat që i detyrohen palët e treta*	Shumat që i detyrohen palëve të treta*
Kompanitë mëmë	2017	3,215	3,287	1,049	2,956
	2016	-	-	-	-
Kompanitë simotra	2017	20,432	793	5,347	615
	2016	1,385	5,647	1,418	238

* Këto shuma janë klasifikuar si të arkëtueshme dhe të pagueshme, respektivisht. (shih shënimet 10 dhe 14).

Kompensimet e manaxhimit

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për periudhën nga 2 nëntori 2016 deri më 31 dhjetor 2016
Paga	2,304	222
Bonuse	15	-
	2,319	222

26. NGJARJE PAS PERIUDHËS RAPORTUESE

Pas periudhës raportuese nuk ka ndodhur ndonjë ngjarje që mund të kërkojë rregullim ose prezantim në pasqyrat financiare.